



Datë: 16.05.2025
Numër Protokolli: 3235/2025

A.nr.555/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtar, me Rushit Kajtazi - në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 555/2025 të datës 26.03.2024 të parashtruar nga ankuesi I.A, kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës së Jugu në çështjen juridike “*vlerësim i rezultateve në punë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.05.2025 mori këtë;

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr. 555/2025 të datës 26.03.2024 të parashtruar nga ankuesi I.A **shfuqizohet** Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin I.A, për vitin 2024 i nxjerr nga Udhëheqësi i Sektorit të Inspekcionit të Transportit Rrugor, ndërsa lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te organi i njëjtë.

II. Obligohet Udhëheqësi i Sektorit të Inspekcionit të Transportit Rrugor në Komunën e Mitrovicës së Jugut, që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative të bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për ankuesin I.A, për vitin 2024.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, I.A (tutje referuar vetëm ankuesi), me datë 26.03.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularit për vlerësimin e rezultateve në punë nga Udhëheqësi i Sektorit të Inspekcionit të Transportit Rrugor në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 02.04.2025 ka proceduar kërkesën për

përgjigje në ankesë tek Komuna e Mitrovicës së Jugut, ndërsa kjo e fundit me datë 11.04.2025 ka kthyer përgjigje në ankesë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën e parashtruar nga ankuesi drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokolli 2017/2025 të datës 26.03.2025; Kopje e letërnjoftimit për I.A; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 27.02.2025, i pa nënshkruar nga palët; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 02.04.2025, dërguar nga R.K, për G.M, përmes emailit; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 555/2025, e datës 11.04.2025; Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimit AE. nr. 01-112/01-0106424/22, i datës 30.11.2022; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën “Inspektor i Komunikacionit”; emali i datës 04.04.2025, dërguar nga G.M, për B.F; emali i datës 04.04.2025, dërguar nga B.F, për G.M; emali i datës 04.04.2025, dërguar nga G.M, për I.A; Raporti Javor nga data 08.01.2024, deri me datën 12.01.2024; dërguar nga I.A, për V.B; Raporti Javor nga data 18.03.2024, deri me datën 22.03.2024; dërguar nga I.A, për V.B; Raporti Javor nga data 25.03.2024, deri me datën 29.03.2024; dërguar nga I.A, për V.B; Raporti Javor nga data 01.04.2024, deri me datën 05.04.2024; dërguar nga I.A, për V.B; ; Raporti Javor nga data 08.04.2024, deri me datën 12.04.2024; dërguar nga I.A, për V.B; Raporti Javor nga data 15.04.2024, deri me datën 19.04.2024; dërguar nga I.A, për V.B; Raporti Javor nga data 29.04.2024, deri me datën 05.05.2024; dërguar nga I.A, për V.B; Raporti Javor nga data 01.05.2024, deri me datën 05.05.2024; dërguar nga I.A, për V.B; Raporti Javor nga data 13.05.2024, deri me datën 17.05.2024; dërguar nga I.A, për V.B; Raporti Javor nga data 20.05.2024, deri me datën 24.05.2024; dërguar nga I.A, për V.B; Raporti Javor nga data 27.05.2024, deri me datën 31.05.2024; dërguar nga I.A, për V.B; Raporti Javor nga data 03.06.2024, deri me datën 07.06.2024; dërguar nga I.A, për V.B; ; Raporti Javor nga data 05.08.2024, deri me datën 09.08.2024; dërguar nga I.A, për V.B; Raporti Javor nga data 12.08.2024, deri me datën 16.08.2024; dërguar nga I.A, për V.B; Raporti Javor nga data 24.06.2024, deri me datën 28.06.2024; dërguar nga I.A, për V.B; Raporti Javor nga data 08.07.2024, deri me datën 12.07.2024; dërguar nga I.A, për V.B; Raporti Javor nga data 15.07.2024, deri me datën 19.07.2024; dërguar nga I.A, për V.B; Raporti Javor nga data 29.07.2024, deri me datën 02.08.2024; dërguar nga I.A, për V.B; Raporti Javor nga data 19.08.2024, deri me datën 23.08.2024; dërguar nga I.A, për V.B; ; Raporti Javor nga data 02.09.2024, deri me datën 06.09.2024; dërguar nga I.A, për V.B; ; Raporti Javor nga data 09.09.2024, deri me datën 13.09.2024; dërguar nga I.A, për V.B; Raporti Javor nga data 16.09.2024, deri me datën 20.09.2024; dërguar nga I.A, për V.B; Raporti Javor nga data 11.11.2024, deri me datën 15.11.2024; dërguar nga I.A, për V.B; Raporti Javor nga data 18.11.2024, deri me datën 22.11.2024; dërguar nga I.A, për V.B; ; Raporti Javor nga data 09.12.2024, deri me datën 13.12.2024; dërguar nga I.A, për V.B; Raporti tre mujor për muajin Janar Shkurt dhe Mars, dërguar nga I.A për V.B; Raporti gashtë mujor janar qershor i vitit 2024, dërguar nga I.A për V.B; Raporti vjetor për vitin 2022; Raporti vjetor për vitin 2024, dërguar nga I.A, për V.B; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2023; Vendimi A.nr.125/2025, i datës 07.03.2025, i KPMSHCK-së.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka gjetur se ankesa është e bazuar dhe se lënda duhet të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje te organi i njëjtë, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës, rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, sipas ndryshimit dhe plotësimit të Akt Emërimit me numër protokolli AE.nr. 01-112-0106424/2022 të datës 30.11.2022, në pozitën “Inspektor i Komunikacionit”, në Drejtorinë e Inspektionit/Sektori Inspektionit të Transportit Rrugor.

Më tej nga shkresat lëndës Kolegji ka gjetur së Udhëheqësi i Sektorit të Inspektionit të Transportit Rrugor, në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të ankuesit, me datë 27.02.2025 ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2024, lidhur me vlerësimin e përgjithshëm e ka vlerësuar me nivelin **“ka nevojë për përmirësim”**.

Duke marr parasysh dispozitat e cekura si më lartë, dhe po ashtu duke marr parasysh provat materiale të lëndës, konkretisht Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 27.02.2025 për ankuesin i cili është vlerësuar në nivelin “Ka nevojë për përmirësim” është vlerësim që tregon se nëpunësi civil nuk ka arritur të përmbushë në mënyrë të plotë pritshmërinë dhe kërkesat për rolin e tij dhe se nga vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2024, është konstatuar se është i pa përgatitur profesionalisht në lëmin adekuate dhe ka marr për bazë vendimin e datës 20.12.2024, të Komisionit Disiplinore të Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe se vlerësimi është bazuar në rezultatet e punës dhe vendimin e datës 20.12.2024, të Komisionit Disiplinore të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Me tej Kolegji i Këshillit konstaton së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes vendimit A.nr. 125/2025, të datës 07.03.2025, ka aprovuar ankesën e ankuesit A.nr. 125/2025, të datës 07.03.2025, si të bazuar në ligj duke e shfuqizuar vendimin me numër protokolli Nr.01-116/01-0063391, të datës 20.12.2024, të Komisionit Disiplinor të Komunës së Mitrovicës së Jugut, ndërsa çështjen e kthen në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë, duke e obliguar Komisionin Disiplinor të Komunës së Mitrovicës së Jugut, që në afatin prej 15, ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë rishqyrtimin e lëndës për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit I.A.

Kolegji i Këshillit konstaton se Shef i Sektorit të Transportit Rrugor, në Komunën e Mitrovicës së Jugut, në rastin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2024, për ankuesin I.A, duke u bazuar në vendimin e datës 20.12.2024, të Komisionit Disiplinore të Komunës së Mitrovicës së Jugut, nuk ka marr për bazë nenin 130 paragrafi 1, të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se; *1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh*

Ankesën, sepse në rastin konkret Shef i Sektorit të Transportit Rrugor, në Komunën e Mitrovicës së Jugut, në rastin e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin I.A, ka marr për bazë vendimin e datës 20.12.2024, të Komisionit Disiplinore të Komunës së Mitrovicës së Jugut, edhe përkundër faktit se lidhur me, vendimin e Komisionit Disiplinor të Komunës së Mitrovicës së Jugut, është parashtruar ankesë nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe lidhur me ankesën e ankuesit Këshilli ka vendosur me vendim A.nr. 125/2025, të datës 07.03.2025.

Nisur nga konstatimet si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se Shef i Sektorit të Transportit Rrugor, në Komunën e Mitrovicës së Jugut, lidhur me çështjen juridike është i obliguar që të beje rivlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin I.A dhe të veprojë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, gjegjësisht neni 52 paragrafi 1,2,3 nën paragrafi 3.1, 3.2, 3.3 si dhe paragrafit 4,5,6 nën

paragrafit 6.1,6.2 dhe paragrafit 11 ku përcaktohet se “*Vlerësimi i rezultateve në punë 1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i vazhdueshëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuara, vlerësimin e aftësisë profesionale, metodologjike, personale dhe sociale të nëpunës/it civil në realizimin e objektivave dhe përmbushjen e përgjithshme të përgjegjësisë të njësisë. 2. Periudha e vlerësimit zgjat një (1) vit, nga 1 janari deri me 31 dhjetor. Procedura e dhënies së vlerësimit përfundon deri më 28 shkurt të vitit pasues. 3. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 3.1. realizimin e objektivave të paracaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave të punës në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe institucionit, si dhe kryerjen e detyrave të atypëratyshme që nuk janë paracaktuar paraprakisht apo nuk kanë mundur të paracaktohen; 3.2. aftësitë profesionale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe sjelljen profesionale; 3.3. aftësitë metodologjike, personale dhe sociale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës. 4.Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunës/it civil bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësen/in dhe përfaqësuesen/in e njësisë së burimeve njerëzore, me shkrim, në muajin janar të çdo viti, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave. 5. Plani individual i punës i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni, mund të rishikohet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësen/in civil. 6. Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë përfshin dy (2) faza kryesore: 6.1. mbikëqyrjen e vazhdueshme të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë; 6.2. vlerësimin vjetor të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 11. Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë gjatë procesit të vlerësimit është e/i obliguar të vlerësojë nëpunësen/in në mënyrë objektive dhe të argumentojë vlerësimin, prandaj bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Kolegji i Këshillit konstaton se Shefi i Sektorit të Transportit Rrugor, në Komunën e Mitrovicës së Jugut, është i obliguar që në bazë të dispozitave ligjore në fuqi të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin I.A, për vitin 2024.*

Nga shqyrtimi i të gjitha fakteve dhe konstatimit të gjendjes faktike dhe juridikë, sa i përket ankesës së ankuesit dhe provave të vërtetuara nga ankuesi dhe organi i punësimit, Kolegji i Këshillit vendosi që të aprovoj ankesën si të bazuar, të shfuqizoj Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin I.A, për vitin 2024 i nxjerr nga Udhëheqësi i Sektorit të Inspektionit të Transportit Rrugor, ndërsa lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë duke e Obliguar Udhëheqësin e Sektorit të Inspektionit të Transportit Rrugor në Komunën e Mitrovicës së Jugut, që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative të bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për ankuesin I.A, për vitin 2024.

Nisur nga konstatimet si me lartë. Kolegji i Këshillit konstaton së organi i punësimit Komuna e Mitrovicës së Jugut, përkatësisht Udhëheqësi i Sektorit të Inspektionit të Transportit Rrugor, pas pranimi të vendimit të Këshillit është i obliguar që të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin I.A, për vitin 2024, duke vepruar në pajtim me Ligjin nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren (QRK) nr. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.555/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtëse

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit I.A;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.